

Komuna e Mamushës  
Data 29.07.2020  
Mbledhja e 06 e Komitetit për Komunitete  
Vendi:Mamushë

## P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e 06 e Komitetit për Komunitete është mbajtur me datë 29.07.2020 në ora 09:00 në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit. Mbledhjen e ka udhëhequr Kryesuesja e kuvendit Znj.Albiona Sadiku. Në mbledhje kanë marrë pjesë 5anëtarë.

### **Albijona Sadiku:**

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Komunitete dhe pjesmarrës tjerë mirë se erdhët në mbledhjen e 06 te rregullt të komitetit për komunitete për vitin 2020.Mund tia fillojmë mbledhjes.

### **Rendi i dites:**

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
- 2.Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;
- 3.Shqyrtimi dhe miratimi i draft rregullores se tatimit ne prone per vitin 2021
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Planit komunal per menaxhimin e mbeturinave
- 5.Të ndryshme

### **1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**

#### **Albijona Sadiku:( Kryesuese e Komitetit)**

A ka dikush diçka me shtu në lidhje me procesverbal i maledhjes së kaluar, nëse e keni parë në emailat e juj i keni pa ne email adresat e juja.

#### **Halim Sadiku**

Ju përshendes të gjithëve. Sa i përket procesverbalit, ata telefonat që na keni dhon neve janë blloku e për me zhblloku po ka punë edhe kërkoj mas sodit kopje fizike me na dërgu, pa marrë parasysh edhe në qoftëse kompjuterin na bini unë kërkoj kopje fizike. Kërkesa jeme është që mas sodit në qoftëse ju nuk keni letër unë letrën ua kompenzoj për shkak se nuk është sikur letra sikur kompjuteri ose ipeadi. Mu ma merr menjë që me kopje fizike kish mu përgjigj qdo kush ma mirë për qdo projekt. Faleminderit shumë. Unë e votoj përshembull procesverbalin kur procesverbalin as që e kam lexu bile.

#### **Albijona Sadiku:( Kryesuese e Komitetit)**

A ka dikush diçka me shtu në lidhje me procesverbal i maledhjes së kaluar, nëse e keni parë në emailat e juj i keni pa ne email adresat e juja, nëse jo atëherë votojmë.

- po(5)
- jo(0)
- abstenim(0)

Me vota unanim u pranua procesverbali.

### **2.Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;**

#### **Albijona Sadiku:( Kryesuese e Komitetit)**

A ka dikush dikush me shktu si pikë të rendit të ditës nëse jo atëhere votojmë.

- po (5)
- jo(0 )
- abstenim (0)

Me vota unanim u pranua.

### **3.Shqyrtimi dhe miratimi i draft rregullores se tatimit ne prone per vitin 2021**

**Albijona Sadiku:( Kryesuese e Komitetit)**

Edhe këtë si material e keni pas në mënyrë elektronike në emailat e juj. Për më tepër spjegime fjalën ia japim Drejtorit të financave Z. Türker Mazrek.

**Türker Mazrek: Drejtor për Buxhet:**

Përshëndetje për të gjithë, sot po ua ofrojmë për votim draft rregulloren e tatimit ne prone per vitin 2021, si qdo vit tjetër edhe këtë vit rregullorja duhet njëherë të votohet si draft mandej si rregullore. Në këtë rregullore nuk ka njdonjë ndryshim të madhë është e njëjtë si qdo vit tjetër. Nëse keni diqka me pyt urdhëroni. Faleminderit.

**Halim Sadiku:**

Zakonisht edhe vitin e kalum e kemi votu edhe e kemi pa që nuk ka naj ndryshim për shkak se kjo vjen prej qendrës thuajse e fiksume as nuk mujna me ngrit as me zbrit. Neve na mbetet vetëm me votu.

**Albijona Sadiku:( Kryesuese e Komitetit)**

Faleminderit shumë. A ka dikush me shtu në këtë pikë, nëse jo atëherë votojmë

- po (5)
- Jo(0)
- Abstenim (0)

Me vota unanime kjo pikë u pranua.

### **4. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Planit komunal per menaxhimin e mbeturinave**

**Albijona Sadiku:( Kryesuese e Komitetit)**

Lidhur me këtë pikë fjalën ia japim zyrtarit i cili ka qenë anëtar i grupit punues Z. Haşim Morina.

**Haşim Morina:**

përshëndetje, do jap disa sqarime lidhur me këtë qështje. Komuna e Mamushës në bashkëpunim me shoqatën Giz dhe me stafin e qendrës për mjedis dhe energji alternative ka hartuar draft planin komunal për menaxhimin e mbeturinave. Për hartimin e këtij plani grupei punues së bashku me stafin i kanë paraparë 6 objektiva më prioritare sa i përket planit, objektivat janë:

- **Hartimi i kuadrit ligjor, rregullator dhe institucional për menaxhimin e mbeturinave – Konsolidimi i strukturës brenda komunës për sistemin e menaxhimit të mbeturinave (2020-2021)**
- **Konsolidimi i shërbimit në zonat ku ofrohet dhe zgjerimi i shërbimit në zonat ku aktualisht nuk ofrohet shërbim (deri në masën 100%) gjatë periudhës 2020-2024**
- **Krijimi i një strategjie komunale për nxitjen dhe vetëdijësimin e qytetarëve për minimizimin e mbeturinave. Minimizimi i mbeturinave urbane që shkojnë në deponi me 5% gjatë periudhës 2020-2024**

- **Sigurimi i qendrueshmërisë financiare, duke optimizuar koston e shërbimit dhe rritjen e nivelit të inkasimeve nga tarifat në zonat ku do të shtrihet shërbimi në masën 100% gjatë peridhës 2021-2024.**
- **Grumbullimi i ndarë i fraksioneve të ndryshme të mbeturinave, duke evitar hedhjen e tyre në konteinerët e mbeturinave komunale**
- **Eleminimi i 12 deponive të egra të evidentuara në territorin e Komunës së Mamushes gjatë viti të parë dhe të dytë të zbatimit të planit 2020-2021**

Ky plan i menaxhimit te mbeturinave perbehet nga 65 faqe por ne u munduam vetëm në pika të shkurtëra të japidisë disa sqarime , nëse keni diqka me pyt urdhëroni.

#### **Halim Sadiku:**

Faleminderit shumë, prej sa kohë jam në Asamble sot jam më i lumburi sepse kanë fillu diqka me bo për menaxhimin e mbeturinave, besoj që keni me ja dalë sepse ai është projekt shumë i madhë por fazë fazë kalohet por me ransi është me fillu. Por keni mujt edhe ma herët ju si komunë me ndërmarrë diqka për qështjen e mbeturinave sepse mu ka marr zoni mo tu fol për mbeturina. Është fatkeqësi e madhe përshtembull se si hudhen mbeturinat në këto deponitë ilegale. Meqenëse je si inspektor në komunë tptaktën keni mujt me bo me bo për mos me ardhë deri tek kjo katastrofë. Mungesa e tabelave paralajmëruese në të dy gjuhët, kjo se keni bo asnijëherë. Unë jam shumë i gëzuar me këtë draft që keni fillu me Gizin apo me kan, ishalla ia dilni. E dyta është që dje veq ka rrjeti edhe një kompani edhe ata ma kanë dhënë një lajm të mirë sepse e kanë ditë që unë mbeturinat i kam shumë iri dhe më thanë që kqyr së mdoket dot realizohet ajo ëndrra që dash me pa qdo sen pastër, që ka ardh një kompani zvicerane amerikane që më të ardhmen e afërt ka me ofru nëpër komuna jo me pagu qytetari por ka mundësi që ajo ka me pagu për mbeturina edhe me ja maledh mbeturinat për shkak se ata e bajnë reciklimin. Kështu që ju përgëzoj për këto, punoni pa u lodh se pastërtia është vet shëndeti i qytetarëve. Faleminderit shumë.

#### **Haşim Morina:**

Unë dashta me shtu edhe diqka tjetër lidhur me këtë qështje, komuna pa e poseduar këtë plan nuk ka pasur mundësi që të aplikojë në asnjë projekt, shembull banka botërore ose komisioni evropian. Disa nga komunat e Kosovës kanë këtë plan, shembull komuna e Shtimjës dhe e vushtisë shumë lehtë po mund të aplikojnë në grande sepse i kanë këto plane. Kjo pasi që është draft keni kohë një muaj që të shtoni ose të hiqni ndonjë propozim. Kërkesa jonë është që këtë ta votoni edhe ju si komision edhe kuvendi.

#### **Albijona Sadiku:( Kryesuese e Komitetit)**

Atëherë kjo pikë le të kalon për votim.Nëse nuk keni diqka me shtu atëherë kalojmë në votim.

-po(5)  
-jo(0)  
-abstinenim(0)

Me vota unanim edhe kjo pikë u votua.

#### **5.Të ndryshme**

Të nderuar pjesmarrës nëse nuk keni diçka për të shtuar atëherë mbledhja e sotme ka përfunduar.Faleminderit për pjesëmarrje.

Shënim mbajtësi  
Idriz Mazrek

Kryesuesjae Komitetit për Komunitete  
Albijona Sadiku